

BEQIR META**PËRPRJEKJET PËR KONSOLIDIMIN E KISHËS
AUTOQEFALE SHQIPTARE SIPAS OPTIKËS
SË DIPLOMATËVE BRITANIKË NË VITET 1925-1928**

Ndër përparësitë e administratës shqiptare pas rikthimit të A Zogut në pushtet ishte konsolidimi i institucioneve kombëtare, midis të cilave vend qendror zinte kisha autoqefale, jetësimin dhe konsolidimin e së cilës, duket qartë, se ajo e kishte përcaktuar si një nga detyrat kryesore dhe, njëkohësisht, e kishte vlerësuar si një sfidë të vështirë, për fitimin e së cilës ja vlente të luftonte dhe, madje, të sakrifikonte.

Fillimisht qeveria shqiptare përcaktoi si rrugën më optimale të zgjidhjes së këtij problemi arritjen e një marrëveshjeje me Athinën. Kjo rrugë kishte përparësi sepse ndikonte në normalizimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe e bënte procesin e afirmimit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare (KOASH) më të lehtë dhe më pak konfliktual.

Në dhjetor të vitit 1925, A. Zogu dërgoi në Athinë deputetin e Gjirokastrës Vasil Bamiha me një mision tepër sekret. Qëllimi i këtij misioni ishte përmirësimi i marrëdhënieve shqiptaro-greke në të gjitha sferat ku vendin qendror e kishte zgjidhja e problemit të Kishës Ortodokse Shqiptare. Aq sekret ishte ky mision sa edhe Ministri britanik Eyres e kishte marrë vesh shumë konfidencialisht. Madje, objektivi i këtij udhëtimi nuk i ishte komunikuar as legatës greke në Shqipëri. Eyres e vlerësonte Bamihan si deputetin ndoshta më të arsimuar të Parlamentit Shqiptar, i cili ishte i shkolluar në Athinë dhe gëzonte besimin e Ahmet beut në një masë të konsiderueshme. Gjithashtu ai shtonte se Bamiha “kishte aprovuar plotësisht qëllimet personale të presidentit për çështjen e minoriteteve të cilat A. Zogu ia kishte shprehur atij së fundi në një bisedë private.”¹ Hapi i ri për afrimin me Greqinë u bë mesa duket pas ardhjes në pushtet të gjeneralit arvanitas Pangallos, i cili shfaqti një predispozicion

¹ *British National Archives, London, Public Record Office; Foreign Office (më tej: FO) FO 371/ 11203, Eyres për Sekretarin e Jashtëm, Austen Chamberlain, Durrës, 22 dhjetor 1925.*

pozitiv ndaj Shqipërisë dhe dha sinjale se do t'i përmirësonte marrëdhëniet midis dy vendeve.

Një hap tjetër u bë në këtë drejtim pas emërimit të gjeneralit Kondulis si ministër i Greqisë në Shqipëri, i cili paraqiti kredencialet tek presidenti Zog më 13 janar 1926. Kondulis ishte një bashkëpunëtor i afërt i Pangallosit. Të nesërmen ai u kontaktua nga diplomati britanik Robert Parr. Gjatë këtij takimi gjenerali tha se çështja e minoritetit grek në Shqipëri dhe ajo e Kishës Ortodokse të këtij vendi, ishin të lidhura ngushtë midis tyre dhe se qeveria e tij do t'i trajtonte ato me energji dhe në mënyrë pajtuese sa më shumë që të ishte e mundur. Ai foli gjerësisht për të dyja çështjet dhe nënvizoi dëshirën që t'i parashtronte legatës britanike konceptin më të qartë që kishte për situatën, sepse e dinte që ajo kishte lidhje të veçanta me A. Zogun dhe sepse ai (Kondulis) natyrisht donte që diplomatët britanikë të mos krijonin ndonjë keqkuptim lidhur me të drejtat apo gabimet rreth një çështje kontradiktore me interes të veçantë për vendin e tij.²

Parr nga ana e tij i tha gjeneralit se, për sa kohë këto çështje mund të ndikonin paqen në këtë pjesë të botës, ato do të shiheshin me interes nga qeveria britanike por, përtej kësaj, Londra nuk ishte e preokupuar direkt. Pastaj ai vuri në dukje se kishte qenë në Shqipëri përreth 4 vjet dhe se ishte i gatshëm t'i fliste Kondulisit për disa çështje që kishte parë. Gjëja e parë që Parr vuri në dukje ishte sugjerimi se “nuk duhet menduar se intrasigjenca e Shqipërisë në këto çështje lidhet vetëm me fanatizmin antikristian ose antigrek. Këto ndjenja ekzistojnë në disa pjesë të opinionit i cili është i shqetësuar se pavarësia e Shqipërisë është fituar me vështirësi dhe ende nuk është siguruar plotësisht. Por gjithashtu ekziston një pjesë e sinqertë e opinionit që është i ndjeshëm ndaj minoriteteve.” Parr sugjeroi se, para së gjithash, besimi ishte themelor për kapërcimin e këtyre vështirësive dhe për zgjidhjen e këtyre problemeve në mënyrë të kënaqshme.³

Gjeneral Kondulis u shpreh se i kuptonte plotësisht këto faktorë dhe se qeveria greke ishte e përgatitur që të jepte garanci më të plota se ajo nuk kishte bërë dhe nuk do të bënte ndonjë veprim ose politikë që synonte helenizimin politik të provincave të Jugut të Shqipërisë. Madje ajo do të bënte edhe një deklaratë zyrtare ku do të shpallte se hiqte dorë

² FO 371/ 11203, Robert Parr për Austen Chamberlain, Durrës, 15 janar 1926.

³ Po aty.

nga “Epiri i Veriut”. Kondulis ishte përgatitur të bënte një turne në këto rajone. Ai do t’i deklaronte popullit publikisht se besnikëria ndaj Patrikatit dhe devocioni ndaj traditës helene nuk duhej të ngatërroheshin me agjitacionin antishqiptar ose të interpretoheshin si një skemë për orientimin politik drejt Athinës. Ai shpresonte që këto deklarata do t’i krijonin mundësi atij që të zgjidhte çështjen e minoriteteve pa turbullira dhe ndjenja keqdashëse që mund të krijoheshin nga parashtrimi i këtyre problemeve në Lidhjen e Kombeve. Ministri i ri grek shpresonte se do të mund ta shtynte A. Zogun të rihapte çështjen e Kishës Ortodokse Shqiptare, që të arrihej në një marrëveshje lidhur me këtë problem të mprehtë, pa ngatërresa dha pa ndonjë agjitacion dhe, kështu, “të spastrohej trashëgimia e hidhur” e Kongresit “të parregullt” të Beratit.⁴

Pas kësaj bisede Parr krijoi përshtypjen se Gjenerali ishte i vetmi zyrtar grek me mendime të qarta, i predispozuar të arrinte objektivin e tij me sa më pak grindje dhe që ishte i vendosur dhe i gatshëm për të qenë miqësor me qeverinë e Shqipërisë. Parr mendonte se ai nuk ishte një njeri që i shmangej gjërave thelbësore dhe shpresonte se “njohuritë e tij për gjuhën shqipe dhe fakti se ai kishte luftuar dhe kishte qenë plagosur për çështjen e Shqipërisë” do të ndihmonin shumë në këtë drejtim.⁵ Në fakt, pavarësisht një predispozicioni shumë më pozitiv i Kondulisit në krahasim me diplomatët e tjerë nacionalistë agresivë dhe megalomanë grekë që kishin qenë para tij, edhe konceptet e diplomatit të ri arvanitas ishin të tilla që shkonin kundër pranimin të së drejtës së shqiptarëve për të krijuar kishën e tyre autoqefale kombëtare. Ky mendim që vijonte të ishte mbisundues në Athinë, do të ishte pengesa kryesore për arritjen e një marrëveshjeje, gjë që do të verifikohet më poshtë.

Progresin në marrëdhëniet greko-shqiptare e vinte në dukje në fillim të shkurtit 1926 edhe diplomati britanik në Athinë, Sër M.Milne Cheetham, i cili informonte se tendencat e një afrimi greko-shqiptar që kishin filluar me caktimin e gjeneralit Kondulis, si ministër grek në Shqipëri duket se tani po jepnin fryte. Kështu dy-tre javët e fundit Vasil Bamiha kishte biseduar me qeverinë greke me qëllim që të zgjidhte çështjet e ndryshme midis Shqipërisë dhe Greqisë. Më 3 shkurt 1926 ishte njoftuar në shtyp se qeveria greke kishte rënë dakord që të pranonte në të ardhmen 5-10 shqiptarë për çdo vit në shkollën ushtarake të Athinës

⁴ Po aty.

⁵ Po aty.

dhe të vendoste gjuhën shqipe si gjuhë e dytë në një numër të rëndësishëm shkollash në Korfuz të cilat frekuentoheshin nga shqiptarë. Cheetham ishte informuar se qeveria greke kishte treguar interesimin e saj të plotë që 5.000 shqiptarët të cilët ishin në proces largimi të qëndronin në Greqi. Ai nuk kishte arritur të mësonte diçka konkrete nëse bisedimet për çështjen e KOSH kishin filluar por mendonte se lëshimet që ishin bërë tani vetëm nga qeveria greke dëshmonin se ajo shpresonte që në këtë mënyrë ta shtynte qeverinë shqiptare të hapte diskutimin për çështjen e Kishës Ortodokse Shqiptare, e cila ishte çështja më e rëndësishme midis të dyja palëve.⁶

Madje, një javë më vonë ai shprehej edhe më me optimizëm për afrimin greko-shqiptar. Ai informonte Londrën se bisedimet midis përfaqësuesit të A. Zogut, Bamiha dhe qeverisë greke po vijonin në mënyrë shumë të kënaqshme. Më 7 shkurt, gjenerali Pangallos kishte shpallur amnistinë (të drejtën për t'u rikthyer) për një numër "myslimanësh shqiptarë të Epirit", të cilët kishin qenë dëbuar për faje e shkaqe të ndryshme. Kjo ishte pasuar nga deklarata e 9 shkurtit e qeverisë greke e cila, si një provë të qëllimeve mirëdashëse ndaj Shqipërisë, kishte vendosur shpërndarjen e sillogjeve vorio-epirote, duke u justifikuar se synimi i tyre për çlirimin e "Vorio-Epirit" nga zgjedha shqiptare ishte kundër politikës së qeverisë. Diplomati britanik vërente se ende nuk kishte ndonjë reagim nga qeveria shqiptare por pritej që çështja e shkollave greke në Shqipërinë e Jugut të zgjidhej në mënyrë të favorshme për Greqinë dhe në përputhje me Deklaratën e 2 tetorit 1921.⁷

Fillimisht Cheetham, duke mos e kuptuar gjithë thellësinë e problemit të Kishës Ortodokse Shqiptare mendoi se ky problem po shkonte drejt zgjidhjes së shpejtë. Ai ishte informuar nga doktor Vigram i cili kishte biseduar më parë me metropolitin e Athinës, se çështja e statusit të ardhshëm të Kishës Ortodokse në Shqipëri ishte në rrugën e zgjidhjes dhe kjo kishë shumë shpejt do deklarohet autonome.⁸ Përfaqësuesi britanik jepte edhe disa të dhëna interesante lidhur me pikëpamjet e Fanarit kundrejt Kishës Ortodokse Shqiptare. Sipas tij, deri

⁶ FO 371/ 11203, Sër M.Milne Cheetham për Sër Austen Chamberlain, Athinë, 3 shkurt 1926.

⁷ FO 371/ 11203, Sër M.Milne Cheetham për Sër Austen Chamberlain, Athinë, 9 shkurt 1926.

⁸ FO 371/ 11203, Sër M. Cheetham për Sër A.Chamberlain, Athinë, 11 shkurt 1926.

në këtë kohë, Patrikati Ekumenik kishte qenë i rezervuar për të pranuar kërkesën e kishës shqiptare për autonomi, pjesërisht prej dyshimit se kjo mbështetej nga intrigat e Rumanisë dhe pjesërisht për shkak të ngurrimit të natyrshëm se do të humbiste një pjesë të juridiksionit të tij të tkurrur. Por tani dukej se Patrikati ishte bindur për rrezikun e ekzistencës së një institucioni kishtar të ortodoksëve në Shqipëri i cili do të ishte i pakënaqur me të. Nga ana e tij, Cheetham sqaronte se zgjidhja e pranuar, në asnjë rast nuk parashikonte krijimin e Kishës Autoqefale të Shqipërisë me peshkopin e saj dhe me atë status që kishte Kisha Ortodokse në Greqi. Kisha autonome që do të pranonte Fanari do të drejtonte çështjet e saj dhe do t'i zgjidhte vetë peshkopët e saj. Ajo do të përfaqësohej tek Patrikana nëpërmjet Epitropëve.⁹

Entuziazmin për përmirësimin rrënjësor të marrëdhënieve greko-shqiptare e shtoi edhe më tej një letër private e të dërguarit të A. Zogut në Athinë, e cila iu drejtua ose ra në dorë të diplomatit britanik R. Parr. Bamiha shkruante se tashmë kishte të gjitha arsyet që të mendonte se misioni i tij kishte qenë i suksesshëm. Atij “i ishte dashur të konvertonte (të ndryshonte mendimin) e të gjithë zyrtarëve” në Ministrinë e Jashtme greke “nga portierët e deri në krye” dhe, kështu, një zgjidhje përfundimtare për çështjet e minoriteteve do të arrihej shumë shpejt; se politika e Greqisë ndaj Shqipërisë do të ishte shumë më pajtuese dhe miqësore se ç’kishte qenë në të kaluarën. Bamiha e ndante këtë sukses në radhë të parë me A. Zogun. Ai shkruante se “suksesi i arritur ishte pjesërisht rezultat i karakterit të Presidentit të Shqipërisë dhe i mënyrës se si ai i kishte drejtuar punët. Qeveria greke, duke u bazuar në raportet e ish-ministrit grek në Shqipëri, Panurias, ishte mjaft e impresionuar nga kjo politikë e Ahmet Beut.”¹⁰

Bamiha u kthye në Shqipëri më 6 mars dhe tre ditë më vonë i telefonoi përfaqësuesit britanik Parr, të cilit i tha dhe një herë se, nga çdo pikëpamje, rezultati i misionit të tij kishte qenë i kënaqshëm. Ai kishte shkuar në Athinë, ku kishte shumë miq dhe mbështetës në qeverinë greke dhe në administratë. Para se të fillonte konferencat zyrtare me ministrat, ai kishte harxhuar tre-katër ditë duke u përpyjekur që t'i bindte miqtë e tij të vjetër në departamente të ndryshme të qeverisë dhe gjetkë të përfaqonin pikëpamjet e tij. Si rezultat i këtyre takimeve përgatitore,

⁹ Po aty.

¹⁰ FO 371/ 11203, R. Parr për Sër A. Chamberlain, Durrës, 23 shkurt 1926.

informonte ai, kishte arritur që t'i zhvillonte bisedimet zyrtare “në atmosferën më të favorshme të mundshme” dhe kishte arritur një përfundim të suksesshëm. Ai kishte zhvilluar bisedime me gjeneralin Pangallos, me zyrtarët e tjerë të lartë Rufos, Panurias, Camados (Drejtor i Përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme) dhe Gjeneralin Sarijanis (Shef i Shtabit të Përgjithshëm). Të gjithë këto “kishin shfaqur dëshirën më të përzemërt për të zgjidhur çështjet me Shqipërinë në një mënyrë të tillë që të vendoseshin bazat e një miqësie të përhershme dhe të ngushtë.”¹¹ Gjatë kohës që ai ishte në Athinë, kishte mundur të influenconte shtypin në një shkallë goxha të madhe. Kështu ishin botuar shumë artikuj të cilët promovonin mirëkuptimin midis dy vendeve. Për më tepër ai kishte arritur të takonte drejtuesit kryesorë të partive politike dhe klubeve të ndryshme dhe të siguronte prej tyre aprovimin e marrëveshjes të cilën ai po e negocionte me qeverinë aktuale greke.

Sipas Bamihas, qeveria greke kishte rënë dakord që të ndalonte aktivitetet e shoqërive “patriotike” të cilat synonin aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Përveç kësaj kishte vendosur të përjashtonte nga shkëmbimi të gjithë çamët me origjinë shqiptare dhe t’ia njoftonte këtë vendim Lidhjes së Kombeve.

Bamiha kishte transmetuar edhe garancitë që kishte dhënë A. Zogu në lidhje me çështjen e shkollave, të cilat e kishin kënaqur tërësisht qeverinë greke.

Për sa i përket çështjes së kishës, qeveria greke duket se kishte qenë e gatshme që të shprehte konsideratat e favorshme ndaj propozimit që statusi autoqefal “i vendosur në mënyrë të parregullt” në Kongresin e Beratit më 1922 të pranohej nga Patrikati. Nga ana tjetër qeveria greke nuk do të angazhohej, në një mënyrë ose tjetër, për ta detyruar Patrikatin, por ajo kishte lënë të kuptohej që mund ta nxiste atë të dërgonte në Shqipëri një komisioner të veçantë, i cili do ta shqyrtonte çështjen gjerësisht dhe kështu do të ishte në gjendje të jepte një vendim përfundimtar. Për këtë mision Patrikana do të caktonte peshkopin Krisanthos të Pontos, të cilin edhe R. Parr e konsideronte si të përshtatshëm për këtë detyrë. Bahima i tha diplomatit britanik Parr se kjo procedurë ishte ndjekur që të ruhej dinjteti i Patrikanës por çështja e kishës mund të konsiderohej si e zgjidhur. Ishte rënë dakord që gjatë kohës së misionit të Krisanthosit të dy palët të mos zhvillonin ndonjë

¹¹ FO 371/ 11203, R. Parr për Sër A.Chamberlain, Durrës, 10 mars 1926.

propagandë lidhur me këtë çështje dhe të shmangnin pasionin popullor kundrejt saj.¹²

Pas këtyre informacioneve R. Parr arriti në përfundimin se nuk kishte gjasa që ndonjëra nga çështjet e mësipërme do të fiksohej në ndonjë marrëveshje të veçantë por theksonte se atmosfera miqësore, e cila u vu re në këto bisedime, do të përforcohej me arritjen e një traktati tregtie, të një traktati ekstradimi dhe një konvente konsullore. Sipas tij, e vetmja gjë që do të zgjidhej me një marrëveshje të shkruar, ishte çështja e kishës. Bamiha ishte përpjekur ta bindte atë se grekët nuk kishin qenë të shtyrë nga ndonjë detyrim politik për të zgjidhur çështjen e diskutuar por, përveç konditave veçanërisht të favorshme, me të cilat ai zhvilloi bisedimet si rezultat i lidhjeve të tij personale, suksesi i tij duhet t'i atribuohet edhe faktit se ekzistonte një dëshirë e vërtetë reale në Greqi për t'u dhënë fund grindjeve me Shqipërinë dhe për të inaguruar një periudhë mirëkuptimi të sinqertë me këtë vend, për t'i shërbyer, kështu, çështjes më të gjerë të paqes ballkanike.

Parr shkruante se rëndësia e kësaj marrëveshjeje nuk mund të injorohej. Në kohën kur Bamiha kishte shkuar në Athinë njohuritë e diplomatit britanik për personalitetin e tij dhe fakti se vetë A. Zogu kishte qenë pesimist, nëse ai vetë mund të arrinte ndonjë sukses, e kishte bërë atë të shpresonte për misionin e tij. "Por, shkruante Parr, rezultati i tij i tejkalon parashikimet e mia. Këto përbëjnë një triumf për negociatorët dhe një sukses diplomatik për qeverinë e Ahmet beut".

Sigurisht koha do të provonte se ky optimizëm dhe kjo shpresë ishin të parakohshme dhe jo realiste. Bamiha i tha Parr-it se kishte marrë vesh që Sër Milne Cheetham e kishte uruar Rufos, në emër të qeverisë britanike, për përfundimet e kënaqshme të bisedimeve. Prandaj edhe ai i kërkonte Foreign Office-it që të mos ngelej prapa dhe të lejohej ta uronte presidentin Zog dhe vetë Bamihan.¹³

Foreign Office e miratoi menjëherë këtë kërkesë dhe e udhëzoi Parr-in se nuk kishte kundërshtim që t'i thoshte Ahmet Beut se qeveria britanike ishte e kënaqur për përfundimin e suksesshëm të bisedimeve, të cilat do të kontribuonin në marrëdhëniet e mira midis Shqipërisë dhe Greqisë.¹⁴ Kjo shprehte dëshirën e sinqertë të britanikëve për t'i parë të

¹² Po aty.

¹³ Po aty.

¹⁴ FO 371 / 11203, Orme Sargent për Parr, FO, 29 mars 1926.

normalizuara marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë. Por nga ana tjetër Cheetham hodhi një hije dyshimi për seriozitetin e pohimeve të Bamihës kur i raportoi Chamberlain-it se ai nuk e kishte uruar ndonjëherë ministrin grek të Punëve të Jashtme për rezultatin e bisedimeve me të dërguarin e A. Zogut, Bamiha.¹⁵

Në ditët e para të prillit filluan të shfaqen shenjat e para të cilat tregonin se euforia për përmirësimin e bujshëm të marrëdhënieve greko-shqiptare dhe për kthesën e madhe që pritej të ndodhte në këtë drejtim ishte e pabazuar. Parr informoi Londrën se Shtabi i Përgjithshëm grek i jepte një rëndësi të madhe marrëdhënieve midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe për këtë arsye grekët kishin qenë shumë bashkëpunues. Ata ishin treguar shumë të shqetësuar nga qëllimet e fundit të Jugosllavisë. Në dokumentet britanike nuk saktësohet se për çfarë qëllimesh konkrete të Beogradit bëhej fjalë. Në ditët e para të prillit të vitit 1926, ministri grek Kondulis i tha atij se ishte i pakënaqur me qëndrimin e qeverisë shqiptare e cila, duket se nuk ishte e prirur që të vlerësonte të gjithë frymën pajtuese që ishte treguar në Athinë. Ai u shpreh se qeveria e Tiranës ishte treguar e papajtueshme me çdo çështje që ai kishte diskutuar kohët e fundit. Kështu, ai kishte filluar të dyshonte se politika miqësore që kishte ndjekur ndaj qeverisë shqiptare mund të mos ishte realisht e këshillueshme.¹⁶

Dyshimet greke u shtuan më tej në momentin e mbërritjes së peshkopit Krisanthos në Durrës, më 1 maj 1926. Diplomatatë britanikë besonin se qeveria shqiptare e neglizhoi detyrën e saj si mikpritëse e peshkopit. Ministri grek ishte zemëruar shumë dhe këtë zemërim ua shprehu diplomatëve britanikë në një mënyrë e cila i bindi ata se ishte e vështirë që ai të ndikonte në krijimin e një atmosfere të favorshme për bisedimet.¹⁷

Megjithëse britanikët nuk e kuptuan menjëherë, ata shpejt do të mësonin se thelbi i mosmarrëveshjeve qëndronte në faktin se grekët dhe Patrikana pranonin një autonomi për Kishën Ortodokse Shqiptare, ndërsa qeveria dhe nacionalistët shqiptarë kërkonin njohjen dhe afirmimin e vendimeve të Kongresit të Beratit për krijimin e Kishës Autoqefale Shqiptare.

¹⁵ FO 371 /11203, Sër Cheetham për A. Chamberlain, Athinë , 31 mars 1926.

¹⁶ FO 371/ 11203, Parr për A. Chamberlain, 4 prill 1926.

¹⁷ FO 371 /11203, O' Reilly për A. Chamberlain, Durrës, 22 maj 1926.

Në vijim Londra u informua për krijimin edhe të një vështirësie tjetër. Një “seksion agresiv” i grupit të kishës ortodokse, me qendër në Korçë, ishte përpyekur të kapte komisionin e emëruar për të zhvilluar bisedimet me peshkopin. Megjithatë kjo pengesë ishte kapërcyer dhe të dy palët ishin futur në bisedime.

Diplomati britanik O'Reilly informonte se ekzistonin katër rryma të opinionit publik në Shqipëri që synonin t'i bënin bisedimet të vështira. Së pari ishte “elementi reaksionar mysliman” i cili ishte i prirur të bllokonte çdo projekt të ortodoksëve. Korrenti i dytë ishte një pjesë e ndershme e opinionit që kishte një mosbesim ndaj grekëve. Pastaj vinte grupi i Korçës, i cili nuk donte të merrej asnjë vendim që pengonte mbizotërimin e tyre në çështjen e kishës ortodokse në Shqipëri. “Dhe gjithashtu janë vllëhtë, shkruante O'Reilly, një element i cili gjendet nën influencën rumune të cilët duket se janë kundër një marrëveshje.”¹⁸ “Duke folur saktësisht, shkruante O'Reilly, qëndrimi i të katër korrenteve që përshkruam më lart është që Kongresi i Beratit i vitit 1922 duhet të konsiderohet si një asamble krejtësisht e rregullt dhe legale dhe nuk ka ndonjë nevojë që çështjet e vendosura në këtë kongres të hapen përsëri me Patrikatën ose me dikë tjetër”. Ky klasifikim i O' Reilly-t është shumë interesant pasi, pavarësisht epitetëve që u vendos kundërshtarëve të politikës greke, ai na jep të dhëna të vlefshme për të kuptuar se cilët ishin mbështetësit e krijimit dhe afirmimit të Kishës Autoqefale Shqiptare në këtë kohë.

Pavarësisht, nga kundërshtitë të cilat “në ndonjë rast ishin vërtet të tmerrshme”, bisedimet arritën në një përfundim të kënaqshëm, shkruante O'Reilly. Ai mendonte se kjo i dedikohet më shumë taktit, zgjuarsisë dhe humorit të mirë të peshkopit Krisanthos por edhe Ahmet Beut, i cili kishte luajtur drejtpërdrejt një rol definitiv, duke këmbëngulur që çështja të cilën ai e kishte diskutuar në Athinë përmes Bamihës, nuk duhej të dëmtohej nga ndjenja apo interesa lokale.¹⁹ Peshkopi Krisanthos së bashku me Pandeli Evangjelin, i cili ishte kryetar i Senatit dhe një anëtar i Komisionit Kishtar, i telefonuan diplomatit të lartpërmendur britanik, të cilit i thanë se ishte arritur një marrëveshje e kënaqshme dhe se ishte hartuar një protokoll paraprak i cili do të nënshkruhej të nesërmen. Pas nënshkrimit të tij peshkopi do t'i kërkonte Patrikatit autorizimin që të

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty.

nënshkruante një marrëveshje përfundimtare me të njëjtën përmbajtje. O'Reilly e uroi ngrohtësisht peshkopin për përfundimin e lumtur të misionit të tij dhe i deklaroi se qeveria britanike do ta priste me kënaqësi të madhe dhe do ta përshëndeste frymën me të cilën u zhvilluan bisedimet prej të dyja palëve.²⁰

Por pas një jave gjithçka u përmbys. O'Reilly informoi Londrën se bisedimet për çështjen e kishës përfunduan në një mënyrë të pakënaqshme, duke shtuar se një gjë e tillë “nuk ishte e panjohur për mënyrën si trajtoheshin çështjet publike në këtë pjesë të botës.” Ai ishte takuar me peshkopin Krisanthos më 26 maj, i cili i kishte thënë se protokollin paraprak nuk ishte nënshkruar dhe se ishin bërë manovra të ndryshme nga pala shqiptare me qëllim që bisedimet të bëheshin të vështira.²¹

Krisanthos i paraqiti përfaqësuesit britanik variantin e tij të zhvillimit të bisedimeve si më poshtë:

- Ai i kishte thënë ministrit të Jashtëm Hysen Vrioni se ishte shumë i pakënaqur me mënyrën se si qeveria shqiptare po e trajtonte këtë çështje. Krisanthos i tha O'Reilly-t se gjatë ditëve të fundit tre anëtarë të komisionit duke përfshirë edhe V. Bamihan nuk ishin thirrur në takim, kështu që ai ishte detyruar të bisedonte me një pakicë jo përfaqësuese. Nga ana tjetër, Pandeli Evangjeli i kishte telefonuar atij disa herë dhe kishte kërkuar rihapjen e një çështje që tashmë ishte vendosur. Kjo ishte çështja e numrit të peshkopëve që do të përbënin Sinodin e kishës shqiptare. Peshkopi Krisanthos kishte këmbëngulur që Sinodi të kishte më së paku 5 peshkopë dhe për këtë palët kishin rënë dakord më parë. Ndërsa tani P. Evangjeli kishte kërkuar që ky numër të ishte katër dhe peshkopi nuk kishte rënë dakord. Krisanthosi u përpoq të bindë O'Reilly-n se rezultati i pashmangshëm i krijimit të kishës autoqefale me një Sinod prej katër peshkopësh do të ishte çelja e rrugës për mosmarrëveshje të brendshme dhe për manovra të jashtme. Këto do të shkonin deri atje, sa do të sillnin si rezultat që kisha do të rrëshqiste në çrregullime dhe përfundimisht në shizëm (përçarje).

Minimumin prej 5 peshkopësh ai e konsideronte si të domosdoshëm për këto arsye:

²⁰ Po aty.

²¹ FO 371 /11203, O' Reilly për A. Chamberline, Durrës, 1 qershor 1926.

- Se peshkopi dhe metropolitani i kishës gjithmonë mund të ishin në gjendje që, me një sinod prej katër anëtarësh, të gjenin një anëtar për të përkrahur pikëpamjen e tij. Kështu, një pjesë e opinionit fetar ose edhe një organizatë e jashtme mund ta kishte të nevojshme vetëm të kapte peshkopin dhe një anëtar tjetër të Sinodit dhe të impononte vullnetin e vet mbi ortodoksët e Shqipërisë. Një situatë e tillë do të ishte skandaloze dhe Patrikati nuk ishte i gatshëm ta pranonte atë. Më mirë se sa të pranonte përgjegjësinë për krijimin e një kisha mbi një bazë të pasigurt, Patrikati do të preferonte t'i linte çështjet në atë pozitë të parregullt në të cilën gjendeshin aktualisht. Një Sinod me 5 anëtarë nuk do të ishte kaq i ekspozuar ndaj manovrave politike dhe korrupsionit politik. Kështu numri 5 ishte minimumi që Patrikana mund të pranonte.

Hysen Vrioni kishte kundërshtuar, duke thënë se kosto për mbajtjen e peshkopatës ishte e rëndë për një kishë të re dhe se reduktimi me 4 peshkopë ishte bërë thjesht për arsye ekonomike. Krisanthos kishte kundërshtuar duke theksuar se mundësitë ekonomike ishin të mjaftueshme. Në fakt shpjegimet që kishin dhënë të dyja palët nuk ishin të sinqerta. Arsyet e vërteta të kësaj mosmarrëveshje ishin: nga njëra anë synimi i Patrikanës dhe i qeverisë greke që të caktonin peshkopë grekë dhe filogrekë për të dominuar Sinodin e KOASH, duke shfrytëzuar për këtë vështirësinë që kishte pala shqiptare për të gjetur klerikë të lartë me formimin e duhur teologjik që të mbështesnin pavarësinë e KOASH dhe interesat kombëtare shqiptare në çështjen e kishës; nga ana tjetër, pikërisht për këtë arsye, pala shqiptare donte ta kufizonte numrin e peshkopëve në katër pasi nuk donte që me numrin pesë t'i krijohet mundësia e lartpërmendur grekëve të vinin nën kontroll Sinodin e KOASH gjë që do të kishte ndikim negativ për kombëtarizimin dhe autoqefalinë e kishës shqiptare.

- Një arsye tjetër e mosmarrëveshjeve që kishin dalë, ishte propozimi i qeverisë që peshkopët e Korçës dhe Beratit të mbeteshin po ata që ishin, ndërsa dy peshkopët e tjerë të caktoheshin nga vetë shqiptarët dhe të emëroheshin nga Patrikana. "Njëri nga këta peshkopë që është në detyrë është një djall i vërtetë", u shpreh Krisanthosi i cili këmbëngulte që tre peshkopë të Senatit të përzgjidheshin nga një listë prej 8 personash e cila t'i ishte paraqitur më parë Patrikanës. Kundërshtimit të Hysen Beut se komuniteti ortodoks i Shqipërisë nuk ishte kaq i madh sa të nxirrte një listë me 8 peshkopë dhe kjo do të bënte që këta të merreshin nga kisha ortodokse jashtë Shqipërisë, Krisanthos iu përgjigj se kjo vështirësi ishte

parashikuar në vitin 1922 dhe vetë Kongresi i Beratit kishte propozuar që disa peshkopë do të silleshin në Shqipëri prej Greqie. Ai i tha ministrit të Jashtëm shqiptar se gjatë bisedimeve kishte mbajtur një qëndrim shumë pajtues. Ai nuk kishte kërkuar anulimin e Kongresit “të parregullt dhe për këtë arsye skizmatik” të Beratit, as nuk kishte kërkuar dënimin e gjithë personave që kishin marrë pjesë në të. Këto gjëra ai mund t’i kishte bërë shumë lehtë, duke u bazuar në Ligjin Kanonik. Krisanthosi pohonte se ai nuk kishte këmbëngulur në heqjen e peshkopëve aktual të Korçës dhe Beratit të cilët kishin kryer “dhunime të hapura kundër kishës” dhe Patrikati Ekumenik mund t’i kishte hequr fare lehtë. Ai theksonte se kishte qenë i gatshëm të pranonte në heshtje veprimet e parregullta të peshkopit Fan Noli. Megjithëkëtë, në kundërshtim me frymën me të cilën kishte negociuar me komisionin shqiptar, ai nuk kishte mundur të merrte koncesionet e duhura dhe kjo do të thoshte fundi i bisedimeve.²²

Peshkopi Krisanthos i tha O’Reilly-t se, me sa kuptonte ai, ekzistonin tre rryma që po vepronin kundër tij. Në radhë të parë ishte qeveria shqiptare, ndoshta edhe elementi “i shumtë dhe reaksionar” mysliman të cilët dëshironin që kisha ortodokse të ishte vetëm një instrument politik në duart e tyre. Kjo shpjegonte dëshirën e tyre për një Sinod të dobët të përbërë nga anëtarë të emëruar prej saj. Në vendin e dytë të kundërshtarëve ai besonte se ishin qeveria jugosllave dhe qeveria rumune të cilat synonin që kisha ortodokse në Shqipëri të ishte e dobët dhe të mos krijohej mbi baza të forta, pasi në këtë rast ata do ta kishin më të vështirë të realizonin pretendimet e tyre politiko-fetare në Shqipëri. Krisanthosi i dha përfaqësuesit britanik disa detaje për këtë si p.sh. veprimet e priftërinjve serbë dhe marrëdhëniet intime midis Pandeli Evangjelit dhe legatës rumune²³. Në fakt ky ishte një keqinterpretim i përpjekjeve dhe objektivave që kishte qeveria dhe përkrahësit e autoqefalisë në Kishën Ortodokse Shqiptare për krijimin e një kisha të pavarur dhe kombëtare. Qeveria shqiptare nuk synonte kurrfarë ndërhyrjeje apo manipulimi të KOASH në favor të objektivave apo interesave politike të ngushta të saj por, ashtu si dhe për të gjitha institucionet e tjera fetare të vendit, donte vetëm kombëtarizimin dhe pavarësimin e saj, çka ishte detyrë themelore dhe jetike e procesit të ndërtimit kombëtar. Grekët e kuptonin fare mirë këtë synim dhe të drejtë

²² Po aty.

²³ Po aty.

të shtetit shqiptar por, për arsye demagogjike, përpiqeshin ta interpretonin atë si një ndërhyrje të qeverisë për të vënë nën kontroll politik kishën ortodokse.

O'Reilly nuk tha asgjë gjatë kësaj bisede, vetëm se theksoi që qeveria britanike do të mirëpriste ndonjë marrëveshje e cila do të ndihmonte për krijimin e konditave të stabilitetit në Shqipëri. Nga ana tjetër ai propozoi që, kur të krijohet një rast i përshtatshëm, ta diskutonte çështjen me kolegun jugosllav, Lazareviç të cilit do t'i theksonte bindjen se një zgjidhje e arsyeshme me Patrikanën do të ishte e vetmja mënyrë për të mbyllur një plagë të hapur dhe të acaruar gjatë këtyre katër viteve të fundit. Gjithashtu O' Reilly i tha Krisanthosit se do t'i sugjeronte ministrit jugosllav realizimin e kësaj zgjidhjeje, pasi ajo ishte në interesin e të gjithë atyre që donin të siguronin paqen në Ballkan. Gjithashtu ai do t'i tregonte atij edhe numrin e anëtarëve të Sinodit që kishte propozuar Krisanthosi.

O'Reilly vinte në dukje se shpërthimi i krizës midis peshkopit Krisanthos e shqiptarëve kishte ardhur atëherë kur bisedimet kishin përfunduar dhe kishte mbetur vetëm nënshkrimi i protokollit. "Kjo, i shkruante ai Londrës, qe një lloj goditje shoku për mua dhe tani nuk mund të parashikoj se çfarë do të ndodhë në të ardhmen." Ai kishte ndryshuar edhe mendimin e mëparshëm pozitiv që kishte pasur për Krisanthosin, si një person i përshtatshëm për t'i çuar përpara bisedimet me shqiptarët. Ai shkruante se nga bisedimet e ndryshme që kishte zhvilluar me Krisanthosin kishte krijuar përshtypjen se Patrikana nuk kishte zgjedhur përfaqësuesin më të mirë për këtë mision. "Njohuritë e tij, durimi i tij, kortezia dhe përcaktimi se çfarë ishte thelbësore dhe çfarë nuk ishte thelbësore kanë qenë faktorët kryesorë për arritjen e marrëveshjes. Por nëse do të analizohet kjo krizë, arsyet e saj qëndrojnë po në të njëjtat arsye".²⁴

Politikën e qeverisë britanike ndaj problemeve greko-shqiptare në përgjithësi dhe asaj të kishës në veçanti, e përcaktonte më qartë dhe e detajonte më tej ndihmëssekretari i Shtetit, Lampson. Ai i shkruante O'Reilly-t se qeveria britanike "aktualisht dhe në përputhje me politikën e saj të përgjithshme, favorizon arritjen e marrëveshjeve që ndikojnë në eliminimin e shkaqeve të grindjeve midis Shqipërisë dhe fqinjëve të saj. Por, qeveria britanike nuk ka ndonjë dëshirë që të implikohet në çështjet

²⁴ Po aty.

e brendshme të Kishës Ortodokse të Shqipërisë ose në politikat e brendshme shqiptare. Edhe ju duhet të shmangni pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në këtë çështje. Natyrisht nuk kemi kundërshtim që ju të jepni këshilla të zakonshme, nëse ju kërkohet mendim por qëndrimi juaj duhet të jetë më shumë vëzhgues sesa aktiv në këtë çështje.”²⁵

Megjithëse bisedimet ishin të vështira më së fundi u arrit në një draft përfundimtar i cili do t’i paraqitej për miratim Patrikanës. Ky protokoll i nënshkruar midis qeverisë shqiptare dhe peshkopit Krisanthos dhe që përmbante propozimet që ai do t’i bënte Patrikanës u afishua në publik si arritja e marrëveshjes. Para largimit nga Shqipëria Krisanthos vizitoi të gjithë qytetet e Shqipërisë së Jugut. Ai u shoqërua në këtë udhëtim nga 4 deputetë shqiptarë. Përfaqësuesi britanik, O’Reilly informonte Londrën se “kudo ai pa se popullsia, jo vetëm ishte e qetësuar për zgjidhjen e një kontradikte të vjetër, por njerëzit ishin më se të kënaqur për mënyrën se si ishte arritur marrëveshja”.

Nga ana e tij, Krisanthos i fshehu pakënaqësitë për rezultatin e bisedimeve, duke qenë i sigurtë se fjalën e fundit do ta thoshte Patrikana në Stamboll. Kështu gjatë turit në Jug të vendit, në mënyrë teatrale, ai propagandoi “suksesin” e arritur në bisedimet për çështjen e kishës. O’Reilly i shkruante Londrës: “Unë kuptova se Krisanthos shfrytëzoi çdo rast për të propaganduar në popullsinë ortodokse të Shqipërisë së Jugut se arritja e kësaj marrëveshjeje, në një shkallë shumë të madhe, i dedikoej veprimit dhe ndikimit të presidentit. Krisanthosi nuk humbi asnjë rast pa përmendur përshtypjet e tij nga takimi me A. Zogun, për personalitetin dhe cilësitë e tij. Unë pashë që peshkopi Krisanthos u prit kudo me një përzemërsi të barabartë si nga ortodoksët ashtu dhe nga myslimanët. Në Tepelenë ai u prit zyrtarisht nga kreu i sektit bektashi të Shqipërisë. Megjithëse është e ditur se demonstrimet popullore, përgjithësisht, janë të orientuara në këtë vend, unë besoj se në këto manifestime pati një masë të konsiderueshme spontaniteti.”²⁶

Shpejt koha do të tregonte se Patrikana e Stambollit nuk do ta pranonte këtë marrëveshje dhe kështu marrëdhëniet e saj me Kishën Ortodokse Shqiptare do të mbeteshin të ndera. Patrikana përpiloi disa kundërpropozime të reja dhe në fillim të shkurtit 1927 dërgoi në Shqipëri

²⁵ FO 371/ 11203, Ndihmëssekretari i Shtetit Miles W. Lampson për William E. O’Reilly, FO, 23 qershor 1926.

²⁶ FO 371/ 11203, O’Reilly për Sër A.Chamberlain, Durrës, 24 qershor 1926.

sërisht peshkopin Krisanthos. Ky informoi përfaqësuesin britanik W. Seeds se kushtet e protokollit përgjithësisht ishin pranuar nga Patrikana. Por, në mënyrë disi të turbullt, ai shtoi se kishte pasur pak vështirësi për përzgjedhjen e disa kandidatëve që do të drejtonin peshkopatat e ndryshme për arsye se një grup nacionalist i ortodoksëve shqiptarë nuk pranonin pamundësinë e gjetjes së peshkopëve të përshtatshëm midis atyre priftërinjve që kishin pasur eksperiencë jashtë vendit. Por sipas tij, “Patrikana ishte treguar pajtuese (bashkëpunuese) në këtë çështje dhe do të pranonte sa më shumë që të ishte e mundur nga kandidaturat për peshkopë që do t’i paraqiteshin nga shqiptarët.” Ajo kishte bërë vetëm një përjashtim për peshkopin e Tiranës, të cilin donte ta emëronte vetë me qëllim që të sigurohej se Kisha Autoqefale do ta fillonte jetën e saj nën drejtimin e një njeriu të aftë. Krisanthos shpresonte shumë se ky qëndrim “i arsyeshëm” i Patrikanës do të bënte që misioni i tij të përfundonte me sukses, me nënshkrimin e një protokollit dhe me miratimin e listës së peshkopëve. I “armatosur” me këto dokumente ai do të rikthehej tek Patrikana dhe marrëveshja përfundimtare do të nënshkruhej nga të dyja palët.²⁷

Por Patrikana nuk kishte revizionuar vetëm këtë pikë të marrëveshjes. Kur Seeds e pyeti Krisanthosin nëse kisha shqiptare do të ishte e lirë të zgjeronte kufijtë e përdorimit të gjuhës shqipe përtej atyre që ishin përcaktuar në protokoll, peshkopi u përgjigj se ajo nuk do të mund t’i zgjeronte këto kufij pasi, sipas tij, “asnjë njeri i arsyeshëm nuk mund të pranojë se gjuha shqipe është e zhvilluar në një mënyrë të mjaftueshme sa që të mund të përdorej në sferën fetare: “Frazat më të lehta të dogmës bëhen të pamundura dhe qesharake kur shprehen në shqipen e sotme e cila është infantile dhe e kufizuar”, deklaroi Krisanthosi.”²⁸ Edhe Seeds, me sa duket, e miratoi këtë mendim. Ai shkruante: “Kjo është e vërteta. Gjuha shqipe është ende aq primitive sa që forca e saj shprehëse është shumë e kufizuar.” Ndonëse motivet politike ishin shkaku kryesor i këtij qëndrimi të Patrikanës, Krisanthosi u përpoq të bindë diplomatin britanik për të kundërtën. Seeds pohonte se peshkopi Krisanthos kishte përjashtuar çdo motiv politik ose qëllim helenizues në këmbënguljen e Patrikanës për mbajtjen e greqishtes së vjetër në një shkallë të gjerë në shërbimet e kishës. Gjithashtu peshkopi i

²⁷ FO 371/ 12069, Seeds për A.Chamberlain, Durrës, 2 shkurt 1927.

²⁸ Po aty.

deklaroi atij se qeveria greke e kishte braktisur sistemin e vjetër të propagandës së saj e cila e konsideronte çdo ortodoks shqiptar si të racës greke, pasi tani në Athinë ishte kuptuar se një Shqipëri e pavarur dhe sa më e fortë ishte jetike për interesat greke.²⁹

Por shumë shpejt edhe përfaqësuesi britanik do të kuptonte se Patrikana kishte dashur ta reviziononte thellësisht marrëveshjen e mëparshme me qeverinë shqiptare. Ai e njoftonte kështu Chamberlainin: “Peshkopi Krisanthos u largua më 1 mars. Ndryshe nga ajo çfarë më pati thënë mua dhe të tjerëve kur ai arriti këtu, doli se ai ishte ngarkuar të diskutonte shtesa të konsiderueshme që do t’i bëheshin protokollit të vitit të kaluar. Këto shtesa përbënin garanci të rëndësishme që i jepnin Patrikanës një autoritet të konsiderueshëm mbi Kishën Autoqefale Shqiptare në të ardhmen. Këto amendamente ishin dukshëm vepër e juristëve grekë të së drejtës fetare të cilët i kishin bazuar sugjerimet e tyre në privilegjet që gëzonte Patrikati në kohët e këqia e të vjetra të Kalifatit në Turqi. Propozimet e peshkopit u kundërshtuan fuqimisht nga qarqet ortodokse shqiptare të cilët nuk pranonin që Shqipëria e sotme të barazohej me Turqinë e Abdyl Hamitit. Në këtë mënyrë negociatat u ndërprejnë.”³⁰ Seeds shtonte se nuk e kishte takuar Krisanthosin para se të largohej nga Shqipëria por ishte informuar nga një autoritet i rëndësishëm se peshkopi ishte bindur për forcën e argumenteve shqiptare dhe kishte lënë të kuptohej se Patrikana nuk duhej të ishte treguar kokëfortë në zgjidhjen e kësaj çështjeje.³¹

Në maj të vitit 1928, mesa duket, pati një përpjekje tjetër për marrëveshje e cila mbeti në mes. Në këtë kohë diplomatët britanikë informuan Londrën se kishin kuptuar që ishte arritur një marrëveshje midis Patrikanës dhe qeverisë shqiptare. Kryetari i senatit shqiptar, Pandeli Evangjeli i tha diplomatit britanik Jordan se në Durrës do të organizohej një konferencë e priftërinjve shqiptarë dhe e komisionit qeveritar, duke përfshirë në të edhe kryetarin e Dhomës së Deputetëve, Koço Kotën. Kjo konferencë do të organizonte Kishën Ortodokse Shqiptare dhe do të emëronte peshkopët e parë të Korçës, Beratit, Gjirokastrës dhe Durrësit. Të gjithë peshkopët do të ishin shqiptarë dhe gjuha shqipe do të përdorej në shërbimet kishtarë aty ku ishte e mundur.

²⁹ Po aty.

³⁰ FO 371/ 12069, W. Seeds për A.Chamberlain, Durrës, 5 mars 1927.

³¹ Po aty.

Greqishtja e vjetër do të ruhej në ato raste kur nuk mund të përkthehej në shqip për momentin, për arsye të fjalorit të kufizuar të gjuhës shqipe.³² Por pas kësaj nuk pati ndonjë zhvillim në këtë drejtim.

Në këtë kohë përfaqësuesi i Francës në Shqipëri, baroni De Vo, bënte një raport mjaft pesimist për gjendjen e ortodoksisë shqiptare. Ai përshkruante problemet që shtronte prania e ortodoksëve grekë në Jug dhe e atyre sllavë në Veri, ngecjen e orvatjes së autoqefalisë, dobësinë e qartë të qeverisë shqiptare kundrejt problemeve fetare, duke u ndalur pastaj në krizën e brendshme të Kishës Ortodokse Shqiptare³³. Mirëpo, diplomati francez, ndonëse kishte të drejtë për rolin pengues që luanin minoritetet e lartpërmendura ndaj autoqefalisë, nuk ishte i saktë për aspektet e tjera të asaj që ai e quante krizë.

Pavarësisht këtyre raporteve e vlerësimeve të diplomatëve të huaj, të cilat na japin një material të vlefshëm për vështirësitë e konsolidimit të kishës kombëtare, procesi i autoqefalisë, jo vetëm nuk ishte në krizë dhe nuk kishte ngecur por eci përpara pa u ndalur, me vështirësi por me vendosmëri dhe në mënyrë efektive. Madje, edhe vetë De Vo çuditej dhe nuk arrinte të shpjegonte se si askush nga ortodoksët shqiptarë nuk e kundërshtoi aspak Kushtetutën e re të vitit 1928 dhe kodet civile e penale të asaj kohe që shënonin një kthesë historike për Kishën Ortodokse Shqiptare. Po kështu do të ndodhte edhe me dekretin e 16 korrikut 1929 mbi bashkësitë fetare, i cili do të pranohej dhe zbatohet nga ortodoksia shqiptare pa ankesa të dukshme³⁴.

Në fund të vitit 1928 qeveria greke ndryshoi ministrin e saj në Shqipëri dhe solli diplomatit e njohur Melas i cili kohët e fundit kishte qenë në Paris. Ashtu si paraardhësit e tij, Melas, u përpoq të bindte homologun e tij britanik Hodgson se kishte ardhur për të realizuar një kthesë pozitive në marrëdhëniet me Shqipërinë. Ai tha se ishte udhëzuar nga Venizelos që të bënte të gjitha përpjekjet për të krijuar një klimë të mirë në marrëdhëniet midis Greqisë e Shqipërisë. Melas shtoi se këto udhëzime të Venizelos i cili donte t'i përmirësonte marrëdhëniet veçanërisht me Shqipërinë, përputheshin edhe me ndjenjat e tij personale.

³² FO 371/ 12844, Jordan për Sër A. Chamberlain, Durrës, 7 maj 1928.

³³ *Ministere des Affaires Etrangères, Archives Diplomatiques, Paris* (më tej: AMAE), Fondi AE, Z Europe 1918-1929, Albanie, vëll. 50, Njoftim i De Vo për MPJ të Francës, 18 prill 1928.

³⁴ Roberto Morozzo della Rocca, *Kombësia dhe feja në Shqipëri (1920-1944)*, Tiranë: "Elena Gjika", 1994, f. 60-61.

Venizelos i kishte thënë atij se ishte e paimagjinueshme se si mund të lejohej një ftohje e marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe grekëve. Kështu duhej bërë gjithçka që të zgjidheshin shkaqet e kontestimeve. Shqiptarët e shpronësuar, tha Melas, kishin një pretendim legjitim për t'u kompensuar për tokën e tyre të konfiskuar në Greqi dhe ata do ta merrnin këtë kompensim. Ndërsa “për çështjen e çamëve dhe çështjen e stërzgjatur të shkollave greke në Shqipëri, Greqia do të tregohej e përmbajtur. Madje ajo do të frenonte aktivitetet e refugjatëve politikë shqiptarë në territorin e saj. Në të gjitha çështjet ajo do të shkonte deri në kufijtë ekstremë të sjelljes së mirë.”³⁵

E vetmja gjë të cilën Melas e konsideronte tepër të vështirë ishte arritja e një marrëveshje për çështjen e kishës autoqefale. Kjo provonte se qeveria greke e cila në shumë raste maskohej me sloganin e ruajtjes së autoritetit të Patrikanës, nuk dëshironte të lëshonte pe në këtë drejtim. Melas duke shtrembëruar në mënyrë flagrante të vërtetën për bisedimet e vitit 1926, i tha ministrit britanik se në vitin 1926, Patrikanës i ishte paraqitur një protokoll nga Krisanthosi dhe Shenjtëria e tij (Patriku) e kishte pranuar atë në kohën e duhur. Por tani qeveria shqiptare, me pretekstin se Patrikana kishte qenë vonuar në pranimin e marrëveshjes, refuzonte të pranonte marrëveshjen që kishte firmosur vetë në atë kohë. Në të vërtetë, tha Melas, shkak i këtij refuzimi ishte nxitja e huaj.³⁶ Më tej Melas u ankua se peshkopët, emrat e të cilëve i ishin paraqitur në vitin 1926 Patrikanës si persona të përshtatshëm për të formuar Sinodin e kishës shqiptare dhe ishin aprovuar atëherë, tashmë nuk pranoheshin prej shqiptarëve. Ai pohoi se ky qëndrim i qeverisë shqiptare, padyshim, lidhej me faktin se këta kishin demonstruar më shumë pavarësi se ajo që dëshironte qeveria. Kështu marrëveshja e vitit 1926 ishte bërë shterpë. Për këtë arsye, tha ai, perspektivat për të arritur sukses në misionin e tij ishin të paragjykuara.

Melas u përpoq që ta maskonte sa më mirë intrasigjencën dhe ndërhyrjen e qeverisë greke ndaj çështjes së kishës autoqefale shqiptare. Ai u përpoq të bindë Hodgsonin se, meqë autoriteti i Patrikanës tashmë ishte goditur nga sulmet e Mustafa Qemalit kundër saj, nëse Shqipëria do të vijonte ta fyente dhe të mos e respektonte Patrikanën, do të shkactohej shumë pakënaqësi në Greqi. Opinioni publik grek vështirë se do ta

³⁵ FO 371/ 12844, R. Hodgson për A. Chamberlain, Durrës, 19 dhjetor 1928.

³⁶ Po aty.

gëlltiste këtë sulm dhe qeveria greke rrjedhimisht do të pengohej që të demonstronte dispozitat miqësore me të cilat ajo ishte e pajisur.³⁷ Mesa duket Hodgson i besoi këto “argumente” dhe i propozoi Foreign Office-t të lejohej që t’i thoshte një fjalë Mbretit Zog dhe ta nxiste atë që të mos humbiste një rast kaq të shkëlqyer për t’i vendosur marrëdhëniet me Greqinë mbi një bazë të mirë. Ai mendonte se më parë duhej mësuar pikëpamja e Mbretit për këtë çështje.

Ministri britanik i tha Melasit se ishte i impresionuar pozitivisht nga qëndrimi pajtues i tij i cili do të gjente një gatishmëri tek Mbreti për t’i zgjidhur çështjet pozitivisht. Megjithëkëtë vërente Hodgson, në çështjen e Kishës Ortodokse A. Zogu ende nuk ishte parë sy më sy me Melasin. Sipas tij, Mbreti ishte shumë i preokupuar që personalisht t’u shmangej kostove të këtij problemi por nuk kishte mundur ta bënte këtë për arsye të refuzimit abstenues të Patrikanës, ndaj frymës së marrëveshjes së përfunduar me peshkopin Krisanthos, sipas së cilës Patrikana do të jepte “tomosin” duke konsakruar karakterin autoqefal të Kishës së Shqipërisë.

Hodgson njihte Londrën se kërkesat e përsëritura drejtuar Selisë së Shenjtë nuk kishin arritur asgjë. Përkundrazi Fanari nuk kishte pranuar t’u njihte pavarësinë ortodoksëve në Shqipëri, por vetëm autonominë me të cilën ata nuk ishin të kënaqur. Patriku i kishte thënë ministrit shqiptar në Athinë se protokollin e vitit 1926 ishte i papranueshëm për të. Shqipëria, nga ana e saj, dëshironte pikërisht që të zbatohet ky instrument. Vështirësia e fundit midis dy palëve ishte krijuar pasi autoritetet greke kishin ndaluar në kufi një peshkop i cili po udhëtonte për në Shqipëri për të zënë vendin e tij në Sinodin e projektuar për KOASH. Pa u krijuar Sinodi, nënvizonte Hodgson, nuk mund të bëhej progres i mëtjetshëm pasi Sinodi do të merrte në dorë qeverisjen e kishës në Shqipëri dhe të zgjidhte problemet me Patrikanën.³⁸

Nga ana e tij, Hodgson e konsideronte të padobishme dhe madje të rrezikshme për prestigjin e qeverisë së tij që të ndërhynte për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje. Kështu që në përfundim të raportit të tij, ai i shkruante Chamberlain-it: “Problemi për palën shqiptare qëndron në faktin se ekziston një kundërshtim i fortë ndaj idesë së lejimit të një Fuqie të huaj të ushtrisë autoritetin brenda territorit shqiptar. Gjithashtu vështirësia qëndron edhe nga mendimi se, në raste të ndryshme, Patrikana

³⁷ Po aty.

³⁸ Po aty.

ka lënduar në mënyrë të papranueshme ndjenjat shqiptare. Në këto rrethana, nëse unë do të ndërhyj ashtu siç sugjerohet prej ministrit grek, jam i sigurt se do të përfshihem në një ngatërrësë të padëshirueshme.”³⁹

Në këtë situatë, ku gjërat kishin mbetur pezull, qeveria greke u mundua të blfonte duke dashur të tërhiqte Londrën në zgjidhjen e problemit të Kishës Ortodokse Shqiptare në përputhje me interesat greke. Në fillim të vitit 1929 grekët artikuluan zyrtarisht shqetësimin e tyre për “rrezikun” që i kanosej Kishës Ortodokse në Shqipëri si rezultat i kalimit në uniatizëm. Ministri grek në Londër i deklaroi Howard Smith se Kisha Ortodokse në Shqipëri do të bëhej Unite dhe se myslimanët shqiptarë në këtë rast ishin të gatshëm të bëheshin katolikë.⁴⁰ Por zyrtarët britanikë, konkretisht ministri në Shqipëri Hodgson dhe Howard Smith mendonin se këto dy parashikime ishin shumë të pabazuara. Hodgson informonte Chambelain se çështja e kishës ortodokse ishte komplikuar nga intrigat e priftërinjve e të tjerëve dhe ishte futur në kaos qysh nga viti 1913 kur pozita e saj ishte kompromentuar rëndë.⁴¹ Ai dallonte dy rryma në këto momente: *Njëra* që njihej si përkrahëse e një “zgjidhjeje nga jashtë”, e cila kërkonte mbajtjen e lidhjeve me Patrikanën dhe një bashkim të ngushtë midis ortodoksëve të Shqipërisë dhe atyre në Greqi. *Tjetra*, që po e rriste influencën e saj kohët e fundit, ishte e identifikuar me një grup “nacionalist ekstrem” dhe po punonte për shpëputjen e plotë nga Patrikana dhe për krijimin e një Kise të Pavarur Ortodokse në Shqipëri. Protagonisti i kësaj rryme e cila kërkonte “zgjidhje nga brenda”, ishte një person “gjysmë i shkolluar” shqiptaro-amerikan që quhej At Vasil Marko, i cili kryesoi Kongresin e Beratit në vitin 1922 dhe po luftonte hapur “vetëm për kënaqësinë e tij personale”. Sipas Hodgson, klerikët e ulët dhe besimtarët në përgjithësi ishin pa dyshim simpatizantë të “zgjidhjes nga jashtë”, por ata dinin pak se çfarë po ndodhte. Ai parashikonte se, nëse grupi nacionalist arrinte të formonte një Sinod dhe, ndoshta mund ta arrinte këtë, këta klerikë do ta injoronin atë pa u hedhur në veprime ekstreme dhe do të vijonin të praktikonin fenë e tyre si në të kaluarën.

Hodgson informonte se Mbreti Zog ishte i lodhur shumë nga kjo çështje dhe ishte i interesuar që të formohej një Sinod. Pavarësisht se si

³⁹ Po aty.

⁴⁰ FO 371/ 13559, Sër Hodgson për A. Chamberlain, Durrës, 10 janar 1929.

⁴¹ Po aty.

do të ishte përbërja e tij, kjo do ta lehtësonte atë nga përgjegjësitë e mëtejshme. Ndërsa qeveria, me aq mundësi sa kishte, mbështeste “zgjidhjen nga brenda”. Ai pohonte se Greqia ishte shumë e ndjeshme dhe e vendosur të ndërhynte në çështjen e Kishës Ortodokse të Shqipërisë. Çdo hap për largimin nga autoriteti i Patrikanës ishte jo i mirëpritur në Greqi. Për këtë arsye, fati i Kishës Ortodokse të Shqipërisë kishte një interes të veçantë për Greqinë. Hodgson bënte këtë koment i cili provonte kufizimet e tij dhe të diplomatëve britanikë në njohjen e historisë së vendit tonë. Ai i shkruante Londrës: “Shqipëria e Jugut është në një pjesë të madhe me gjak grek dhe që prej kohëve të vjetra ka pasur kulturë greke. Kisha e saj (greke), si rezultat i standardeve të ulëta arsimore, ka mbizotëruar dhe mungesa e mundësive të formimit të priftërinjve në këtë rajon, ka bërë që ata të shkolloheshin jashtë. Sistemi i krijuar gjatë Perandorisë Osmane mori goditjen e parë më 1913 pas pavarësisë shqiptare. Ndërsa kohët e fundit ai mori një goditje fatale nga shpërthimi i shovinizmit i cili shoqëroi shpalljen e monarkisë.” Duhet vënë re se rritjen e ndjenjave patriotike në Shqipëri pas shpalljes së Monarkisë, Hodgson e cilësonte gabimisht si shpërthim të shovinizmit.

Gjithsesi raporti i tij përmbante komente shumë interesante lidhur me interesat që kishte Greqia në lidhje me kishën shqiptare. Hodgson pohonte se jo vetëm që Greqia po humbte pozitën prej tutori që kishte pasur tradicionalisht mbi ortodoksët shqiptarë por ajo e ndjente se një shizëm (ndarje) e cila do ta privonte Fanarin nga besnikëria e shqiptarëve, do ta dëmtonte më tej autoritetin e dobësuar të Patrikanës. Ai pohonte se gjithashtu mund të besohej se në qëndrimin e Greqisë kishte njëfarë altruizmi, pra që ajo ishte vërtet e shqetësuar për të ardhmen e ortodoksisë kur kjo të binte në duart e “teologëve rrugaçë (apo që janë lllum i ortodoksisë)” si Vasil Marko. Pra, Hodgson kishte bërë të tijën thelbin e propagandës greke e cila u përpoq që t’i diskreditonte të gjithë ata klerikë shqiptarë që mbështetën dhe jetësuan autoqefalinë si “rrugaçë”, “imoralë”, “të pëditur” etj. Kapja pas nivelit të pamjaftueshëm teologjik të këtyre aktivistëve të autoqefalisë dhe të atyre që kishte propozuar pala shqiptare për formimin e Sinodit ishte arma e preferuar e Patrikanës dhe e Athinës për të sfiduar procesin e autoqefalisë.

Hodgson nuk përjashtonte edhe faktin që shqetësimi i Greqisë kishte ardhur edhe ngaqë Vatikani munde të përfitonte nga çrregullimet e Kishës Ortodokse. Verën e kaluar dy priftërinj ortodoksë në Elbasan ishin konvertuar në unitë dhe kishin hapur një kishë unite. Ndonëse pranonte

se nuk ishte i qartë dhe i informuar mirë, Hodgson mendonte se mund të kishte raste të tjera të apostazisë (konvertimit) midis priftërinjve. Gjithashtu ai vërente se natyrisht kishte pasur konvertime në uniatizëm edhe midis laikëve. Ai i referohej gazetës “Osservatore Romano” e cila kishte botuar një artikull që komentonte përpjekjet e një misionari ortodoks për të realizuar këtë konvertim. Duke komentuar ndikimin e këtij artikulli në qëndrimet e fqinjëve ai shkruante: “nuk nevojitet asgjë më tepër për t’i bindur grekët dhe serbët se po realizohet një komplot me rrënjë të thella për të zëvendësuar Fanarin me Vatikanin dhe se Mbreti Zog, i cili sipas thashethemeve, po mendonte të kalonte në katolicizëm, do ta ndihmonte këtë proces”.

Ministri britanik zbulonte edhe mashtrimin e madh që po bënte qeveria greke e cila u kishte premtuar zyrtarëve shqiptarë se, nëse hiqnin dorë nga kisha autoqefale, atëherë do të zgjidheshin të gjitha problemet me Greqinë e në radhë të parë çështja e kompensimit të pronave të shqiptarëve të sekuestruara nga shteti grek. “Në këtë situatë, shkruante Hodgson, një ministër grek i cili, i preokupuar për të zgjidhur një çështje për të cilën është krejtësisht i pavetëdijshëm, i ngarkuar me një entuziazëm pa kufi dhe jo i zgjuar është futur në një mashtrim dhe u ka propozuar shqiptarëve që t’i rikthehen protokollit të miratuar me peshkopin Krisanthos më 1926, duke aluduar se zgjidhja e çështjes së kishës ortodokse, në përputhje me pikëpamjet greke, do të ndikonte pozitivisht mbi opinionin grek të krijuar në Greqi i cili pengon zgjidhjen e kërkesave ekonomike shqiptare ndaj qeverisë greke. Siç e mendoj unë, ky aludim, i cili është i afërt me një mashtrim është i rrezikshëm. Për këtë arsye zotit Melas i duhet thënë se një gënjeshtër e tillë, në një kohë kur Shqipëria me dhimbje po ndërton një ndërgjegje kombëtare, më shumë do ta dëmtonte sesa do ta avanconte çështjen greke”.⁴²

Hodgson vërente se çështja e kishës nuk u zgjidh shpejt përpara se të vijonin intrigat të cilat tashmë po dominonin situatën. Kështu që ajo kishte kohë për të pritur që të zgjidhej. Ndonëse nuk e thoshte hapur dhe tekstualisht ai ia vinte fajin qeverisë greke për mosarritjen e një mirëkuptimi. Ai shkruante: “Të përpiqesh të përpjesëtosh përgjegjësitë për vonesën e kësaj zgjidhje është jo fitimprurëse. Madje edhe para disa muajve ka qenë e mundur të krijohet një Sinod i cili do të kishte kënaqur aspiratat greke për dy peshkopë. Unë besoj se teologët me reputacion, si

⁴² Po aty.

Kotoko dhe Vasil Joanidis, arritën në Shqipëri në verë të ftuar nga shqiptarët, për të zënë vendet e tyre në Sinodin e KOASH. Por ky shans humbi pasi konflikti i interesave dominoi mbi avantazhet e kësaj zgjidhje. Tashmë grupi që mbështet “një zgjidhje nga brenda” ka marrë përfundimisht situatën në dorë. I fundit që ka aderuar në këtë grup është peshkopi i Korçës, i cili indirekt kishte mbajtur lidhje me Greqinë. Kështu Sinodi i cili, sipas të gjitha gjasave do të formohet në të ardhmen e afërt, duket se do të jetë shumë i ndryshëm nga ai i përcaktuar në Protokollin e vitit 1926. Peshkopët e Korçës dhe Beratit që janë treguar përkrahës të ndarjes me Patrikanën, pa dyshim do të jenë anëtarë të Sinodit dhe një student i ri teologjie me emër Toma është thënë se do të jetë anëtar i tretë. Anëtari i katërt do të jetë Visarion Xhuvani, një peshkop i konsakruar në Jugosllavi i cili, për një farë kohe, ka qenë ndihmës i peshkopit në Durrës, por ka qenë i padëshirueshëm për besimtarët e tij për shkak të jetës së shturur. Zgjedhja e tij, nëse do të bëhet, do të jetë rezultat i mbështetjes jugosllave. Serbët ose ministri i tyre këtu, duke mos qenë në gjendje ta gëlltisnin një intrigë, në të cilën grekët po marrin pjesë dhe prej së cilës serbët janë përjashtuar, do të mbështesë Visarionin”.⁴³

Nga kjo tablo koncize dhe tepër interesante kuptohet se refuzimi i Patrikanës dhe i qeverisë greke për kompromisin e arritur më 1926 i kishte shtyrë shqiptarët ta zgjidhnin çështjen e kishës në një mënyrë edhe më patriotike ose radikale siç e quante diplomati britanik. Pra shkaktarët e këtij radikalizimi kishin qenë vetëm grekët.

Hodgson theksonte se nga këndvështrimi i interesave greke ky Sinod do të ishte i keq dhe nuk do të përmirësonte gjendjen e Kishës Ortodokse në Shqipëri. Por ai mohonte se ky Sinod do të kishte prirje në drejtim të uniatizmit dhe shtonte se ishte e pamundur që një grup i cili qëndronte prapa një lëvizjeje, deviza e së cilës ishte nacionalizmi, do të shkëpuste lidhjet me Athinën për t’i vendosur me Romën.

Interesante ishte edhe analiza që i bënte ministri britanik devizës tjetër të propagandës greke, konvertimit të mundshëm të myslimanëve në katolicizëm. Ai pohonte se kalimi i myslimanëve të Shqipërisë drejt katolicizmit en bloc, ishte edhe më i pamundur. Megjithatë ai nuk e quante surprizë përhapjen e këtyre thashethemeve dhe gëlltitjen e tyre prej shumë njerëzve në sfondin e raporteve shqiptaro-italiane dhe

⁴³ Po aty.

shqiptaro-greke të kësaj kohe dhe kur thashethemet për konvertimin e Mbretit në katolicizëm, si një parakusht për martesën e tij italiane, ishin shpërndarë gjithandej dhe ishin pranuar në çdo vend, nga kufiri me Greqinë deri në Shkodër. Ndryshimi i besimit të Mbretit, supozonte Hodgson, do të kishte si rrjedhojë të natyrshme një ndryshim të ngjashëm në të gjithë fisin e Matit. Mirdita që shkonte me Matin dhe ishte fisi më i fuqishëm në Shqipëri, kishte qenë gjithmonë katolike, kështu konvertimi i Mbretit do të krijonte një bllok katolik solid i cili do të formonte një bastion përgjatë Shqipërisë Qendrore. Hapi tjetër, hamendësonte ai, do të ishte konvertimi me anë të detyrimit ashtu siç e kishte praktikuar Skënderbeu ose konvertimi prej interesit të shumicës myslimane të popullsisë.⁴⁴

Por ai vetë e quante të gabuar këtë konstrukt argumentimi, pasi bazohej në diçka që nuk ekzistonte. Ai e quante absurd hamendësimin që Ahmet Beu të kishte bërë ndonjë aludim për kthimin në uniatizëm të ortodoksëve. Hodgson pohonte se ai dëshironte t'i jepte pavarësinë popullsisë ortodokse shqiptare. Kur ai kishte qenë në Tiranë në vitin 1926 ishte bindur se krijimi i një kisha autoqefale në Shqipëri ishte bërë i paevitueshëm. Atëherë ishte arritur një konkordat sipas të cilit Patrikana do të lëshonte Tomosin, në këmbim të garancisë se qeveria shqiptare do t'i lejonte kishës së re të drejta të rëndësishme që ishin themelore për ekzistencën e saj. Patrikana nuk e dha kurrë Tomosin, ndërsa qeveria shqiptare e siguroi zyrtarisht atë se do të zbatonte konkordatin. Por më tej ajo me këmbëngulje kundërshtoi zbatimin e tij pasi Tomosi nuk iu dha. Një muaj më parë, pra në dhjetor 1928, Patrikana i kishte drejtuar një telegram qeverisë shqiptare ku premtonte se do të vepronte me shpejtësi nëse qeveria shqiptare pranonte konkordatin. Por ky telegram mbeti pa përgjigje. Peshkopi Krisanthos i kishte thënë Hodgson se ndryshimi i mendimit të Mbretit Zog përkonte, të paktën nga pikëpamja kronologjike, me braktisjen e Jugosllavisë në favor të mbështetjes italiane. Sipas tij, qarqe të caktuara italiane nuk dëshironin që të zgjidhej çështja e Kishës Ortodokse Shqiptare, pa u plotësuar kërkesa italiane për autonominë e kishës ortodokse në Dodekanez.

Sipas Krisanthos, vështirësia kryesore qëndronte në dëshirën e qeverisë shqiptare për të kontrolluar plotësisht autoritetet kishtarë. Në fakt ky ishte një interpretim jo i saktë i përpjekjeve të qeverisë shqiptare

⁴⁴ Po aty.

për ta pavarësuar dhe kombëtarizuar kishën. Krisanthos i tha Hodgson-it se dy peshkopë me qëndrim në Shqipëri nuk kishin pranuar dëshirën e qeverisë shqiptare për të krijuar një Sinod, pa marrë më parë miratimin e Patrikanës. Për më tepër, Patrikana nuk kishte refuzuar asnjëherë emërimin e ndonjë kleriku të caktuar nga qeveria shqiptare. Krisanthosi mohoi edhe pengimin e peshkopëve në kufi nga autoritetet greke. Ai i tha Hodgson-it se peshkopi, për të cilin flitej se ishte ndaluar në kufi, mund të kishte qenë metropolitani i Nea Pergamia, i cili nuk ishte penguar nga autoritetet kufitare greke, siç ishte pretenduar nga Mbreti Zog, por ishte bindur nga autoritetet kishtare në Athinë, duke filluar që nga vetë Krisanthosi, i cili e konsideronte krijimin e një Sinodi, pa marrë më parë garanci se qeveria shqiptare do ta lejonte atë të ushtronte detyrën e tij në një mënyrë të kënaqshme, si një hap që nuk do të ishte në interes të popullsisë ortodokse të Shqipërisë.⁴⁵

Ndonëse qeveritarët grekë artikulonin shpesh shqetësimin për cënimin e autoritetit dhe prestigjit të Patrikanës dhe ndikimin që do të kishte kjo në opinionin grek, kjo nuk dukej shumë bindëse. Diplomati britanik në Greqi, Usher mendonte se pjesa e opinionit grek që shqetësohej për çështjet kishtare, nuk ishte i shqetësuar më së shumti për prestigjin e Patrikanës. Por publiku grek mendonte se popullsia ortodokse e Shqipërisë e cila ishte e racës dhe gjuhës shqipe, kishte të përbashkët me grekët kulturën bizantine dhe po trajtohej jo mirë në krahasim me pjesën myslimane të popullsisë dhe me fiset katolike në Veri, të cilat kishin përkrahjen e Italisë.⁴⁶

Usher evidentonte qartë edhe mosmarrëveshjet midis Patrikanës së Stambollit dhe Kishës Serbe, të cilat e kishin bërë edhe më të komplikuar situatën. Ai i shkruante Londrës se Shkodra kishte qenë gjithmonë nën juridiksionin e Patrikanës Ekumenike dhe jo të Kishës Serbe. Gjatë periudhës kur jugosllavët po përpiqeshin të fitonin influencë në Shqipërinë veriore një prift serb u emërua si peshkop i Shkodrës. Konsakrimi ishte bërë nga peshkopët rusë me qëllim që hierarkia serbe t'i shmangej përgjegjësisë. Megjithëkëtë vikari i Përgjithshëm i Peshkopatës Serbe të Cattaros, ku u bë konsakrimi, kishte qenë prezent në ceremoninë e tij. Patrikana Ekumenike nuk e njohu vlefshmërinë e këtij konsakrimi dhe as nuk pranoi se Patrikana Serbe kishte ndonjë të drejtë në këtë

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Po aty.

çështje. Patrikana nuk kishte kundërshtim që popullsisë ortodokse “serbofone” në Shqipërinë e Veriut, t’i njëhej e drejta të përdorte sllavishten e vjetër si gjuhë liturgjike, por ajo nuk pranonte në asnjë mënyrë që peshkopata e Shkodrës të varej nga autoritetet kishtare serbe dhe të çlirohej nga varësia prej Patrikanës.⁴⁷

Në vlagën e kësaj qorrollisje shqiptaro-greke për çështjen e kishës edhe përfaqësuesi i ri grek Melas, ashtu si paraardhësit e tij dhe në kundërshtim me sa kishte deklaruar në fillim të misionit të tij, nxorri në pah personalitetin e tij nacionalist dhe konfliktual. Melas i foli Hodgson-it për ndryshimet e opinioneve midis tij dhe Caclamanos (Ministri grek në Londër). Ai tha se kishte biseduar për gjendjen e Kishës Ortodokse Shqiptare me një anglez që quhej Stroud Read i cili po punonte për krijimin e bibliotekës Elizabeth Carnavon në Tiranë. Melas e kishte përshëndetur propozimin e Read se ai do të përdorte njohjet që kishte me Canon Douglas, i cili ishte një figurë e rëndësishme në grupin anglo-ortodoks në Londër, për të marrë një sërë artikujsh të publikuar në shtypin britanik me qëllim që të sigurohej simpatia e opinionit britanik për ortodoksët shqiptarë.⁴⁸ Hodgson tashmë informonte se gjysmëzyrtarja “Gazeta e Re” e kishte sulmuar Melas për ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë; ministri jugosllav e kishte akuzuar se ai ishte sjellë jo mirë me të; ministri italian i kishte dhënë atij një leksion se po peshkonte në ujëra të turbullta, duke ndikuar në rritjen e pakënaqësive midis Romës dhe Athinës. “Me pak fjalë, përfundonte ministri britanik, zoti Melas ka bërë një debutim fatkeq në diplomacinë për çështjen shqiptare”.⁴⁹

Për sa i përket KOASH, ai vinte në dukje se ajo ende nuk kishte një Sinod dhe nuk kishte shenja se lufta dhe intrigat e jashtme e të brendshme do të pushonin. Grekët kishin deklaruar se peshkopi V. Xhuvani ishte në tratativa me Vatikanin për të marrë kryesinë e lëvizjes uniate midis ortodoksëve shqiptarë, duke vënë si kusht që ai të konfirmohej në funksionet episkopale. Ministri jugosllav, i cili besonte ose dëshironte të besonte, në besnikërinë e Xhuvanit ndaj ortodoksisë, i njihte atij cilësi (të cilat Hodgson mendonte se nuk i kishte) dhe e kundërshtonte mundësinë e konvertimit të V. Xhuvanit. Ndërsa vetë

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ FO 371/ 13559, Sër R.Hodgson për A.Chamberlain, Durrës, 28 janar 1929.

⁴⁹ Po aty.

Hodgson theksonte se konvertimi në uniatizëm nuk po ndodhte dhe shprehej me vendosmëri se ky ishte opinioni i tij përfundimtar. Nga ana tjetër ai pranonte se mund të ndodhnin raste të veçanta konvertimi në uniatizëm dhe se mund të kishte një proces gradual konvertimi. Çorientimin që vërehej midis ortodoksëve në këtë kohë ai e vlerësonte si një faktor që mund të sillte një rezultat të tillë.⁵⁰

Në këtë atmosferë të nderë të gjendjes së KOASH, e cila ishte proklamuar në Kongresin e Beratit, që mbështetej nga legjislacioni civil shqiptar si dhe nga faktorë të rëndësishëm brenda vendit, qeveria shqiptare e gjendur përballë kundërshtimit kokëfortë grek do të ecte përpara në rrugën e formëzimit të kishës me të gjitha institucionet e saj. Hapat e mëtejshëm të saj dhe rezultatet e tyre do të trajtohen në një artikull që do të botohet në numrin e ardhshëm të kësaj reviste.

S u m m a r y

THE ENDEAVORS FOR THE CONSOLIDATION OF THE AUTOCEPHALOUS CHURCH IN THE EYES OF THE BRITISH DIPLOMATES DURING 1925-1928

A priority of the Albanian administration after the return in power of A. Zogu, was the strengthening of national institutions among which the Autocephalous Orthodox Church of Albania (AOCA), the existence and consolidation of which was obviously one of the aims and at the same time challenges of this administration and for which it was willing to struggle and even sacrifice.

Based on the British diplomatic documents, the majority of which is consulted for the first time, this paper aims to analyze the whole diplomatic endeavors done by the Albanian government for the recognition of the AOCA by the Greek state. The paper deals with the negotiations with the Greek government from 1925 to 1928, and also the debates with the Church Commission that the Greek Patriarchate of Constantinople had sent to Albania. In the paper will also be presented the attitude of the British diplomacy towards the Albanian Orthodox Church and some aspects of the Albanian-Greek

⁵⁰ По аты.

relations. It is interesting to see how the British diplomats have analyzed and summarized the Christian Albanians' opinion with regards to Autocephaly.

The Albanian government and the Patriarchate were close to an agreement but eventually the Patriarchate withdrew from it. As a result Tirana was forced to give a more 'revolutionary' solution to the issue by establishing the Synod of AOCA from within the country, without the consent and blessing of the Patriarchate. This resulted in the worsening of the relations with the Patriarchate and with Athens, while both tried to prevent the international recognition of the Autocephalous Orthodox Church of Albania.